



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 60, Datë 15.03.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “LUCENTE KONCESIONARE” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTIRIKE NGA HEC
“SPATHARË” ME FUQI TË INSTALUAR 1038 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “a”, 39 pika 3 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e b të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Lucente Koncesionare” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Spatharë” me fuqi të instaluar 1038 KW,

Konstatohet se:

- Me shkresën nr. 11 Prot, datë 09.01.2018 shoqëria “Lucente Koncesionare” sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Spatharë” me fuqi të instaluar 1038 KW.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 28 datë 30.01.2018 filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Lucente Koncesionare” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Spatharë”.
- Shoqëria “Lucente Koncesionare” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i Kontratës Koncesionare, datë 02.05.2013, të lidhur ndërmjet bashkimit të shoqërive “Lucente” sh.p.k. dhe “Loshi BL” sh.p.k., me cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në zbatim të VKM-së nr. 703, datë 11.06.2009, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të Hec “Spatharë”.
- Ortak i vetëm i shoqërisë “LUCENTE KONCESIONARE” sh.p.k. rezulton të jetë shoqëria “LUCENTE” sh.p.k., ortak i së cilës është shoqëria “Idroalbania” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 7320/1 Prot, datë 13.12.2010, drejtuar shoqërisë “Lucente Koncesionare” sh.p.k., Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në atë kohë METE) ka miratuar projektin

e zbatimit për ndërtimin e Hec “Spatharë”, sipas propozimit të paraqitur nga projektuesit e projektit të zbatimit dhe të oponencës teknike të Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore. Sipas projektit të zbatimit, të miratuar si më sipër, fuqia e instaluar e Hec “Spathare”, është 1038 KW, po aq sa është përcaktuar në Kontratën e Koncesionit.

Aplikimi i shoqërisë “Lucente Koncesionare” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 gërmat “a”, “b” “c”, 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, 4.1.5 gërmat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Lucente Koncesionare” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Spatharë” me fuqi të instaluar 1038 KW, për një afat 30 (tridhjetë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI